

**METODOLOGJIA, PROCEDURAT
DHE INSTRUMENTET
PËR MENAXHIMIN
E ZHVILLIMIT PROFESIONAL
të profileve profesionale të punësuar
në kopshte të fëmijëve**

-DORACAK -

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare dhe të ekspertëve nga projekti i BE-së "Rritja e cilësisë së edukimit dhe kujdesit parashkollor" **EuropeAid/139823/IH/SER/MK**

Titulli:

METODOLOGJIA, PROCEDURAT DHE INSTRUMENTET PËR MENAXHIM E ZHVILLIMIT PROFESIONALE
TË PROFILEVE PROFESIONALE TË PUNËSUAR NË KOPSHTË TË FËMIJËVE – DORACAK

Titulli i origjinalit: МЕТОДОЛОГИЈА, ПРОЦЕДУРИ И ИНСТРУМЕНТИ ЗА УПРАВУВАЊЕ СО
ПРОФЕСИОНАЛНИОТ РАЗВОЈ НА СТРУЧНИ ПРОФИЛИ ВРАБОТЕНИ ВО ДЕТСКИ ГРАДИНКИ –
ПРИРАЧНИК (përkthyer nga maqedonishtja në gjuhën shqipe)

Автори: Проф. д-р. Јасмина Клеменович, Проф. д-р. Алма Тасевска, проф. д-р. Светлана Лазик

Botues:

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

Për botuesin: Ministri Fatmir Limani

Autorë:

Prof. Dr. Jasmina Klemenoviq

Prof. Dr. Alma Tasevska

Prof. Dr. Svetlana Laziq

Redaktor:

Prof. Dr. Alma Tasevska

Përpunimi kompjuterik:

TEDI TREJD KOM sh.p.k. Shkup

Përkthimi: KONTINEO sh.p.k. Shkup

Shtypshkrinja: TEDI TRADE COM sh.p.k. Shkup

Tirazhi: 100 kopje

CIP - Katalogimi në botim Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

ISBN: 978-608-249-607-8

COBISS.MK-ID 64685573

Viti dhe vendi i botimit: 2024, Shkup

Shënim

Përmbajtja e këtij doracaku është përgjegjësi e vetme e Archidata s.r.l. dhe partnerët e saj në konsorcium dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

PËRMBAJTJA:

PËRMBLEDHJE.....	5
1. NOCIONET THEMELORE	7
2. Metodologjia për zhvillim profesional	
të profileve profesionale në kopshtet e fëmijëve	8
2.1 Menaxhimi i zhvillimit profesional	
të profileve profesionale në kopshtet e fëmijëve	11
2.2 Programet për zhvillim profesional	13
3. Instrumentet për menaxhimin e zhvillimit profesional	
të profileve profesionale në kopshtet e fëmijëve	16
Faza e I-rë: Monitorimi i cilësisë së punës së stafit edukativo-arsimor	
si bazë për planifikimin e zhvillimit profesional	17
INSTRUMENTET E FAZËS SË PARË	19
Faza e II-të: Planifikimi i zhvillimit profesional	
në funksion të vetëvlerësimit të kompetencave profesionale	
si bazë për planifikimin e zhvillimit profesional	27
INSTRUMENTET E FAZËS SË DYTË	29
Faza e III-të: Efektet e zhvillimit profesional	51
INSTRUMENTET E FAZËS SË TRETË	53
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	58

PËRMBLEDHJE

Ky dokument paraqet një **koncept të metodologjisë, procedurave dhe instrumenteve për menaxhimin e zhvillimit profesional të profileve profesionale të punësuar në kopshte për fëmijë**. Ky dokument përfshin temat e mëposhtme:

- Metodologjia e zhvillimit profesional të profileve profesionale në kopshte
- Menaxhimi i zhvillimit profesional të profileve profesionale në kopshte
- Programet për zhvillim profesional
- Instrumentet për menaxhimin e zhvillimit profesional të profileve profesionale në kopshte në tre faza

Dokumenti paraqet strukturën bazë dhe përshkruan pamjen e instrumenteve për nevojat e zhvillimit profesional të punonjësve në kopshte. Instrumentet monitorojnë të gjithë procesin e zhvillimit profesional nga fillimi deri në fund, kështu që zbatimi i tyre mund të ndahet në disa faza:

- Faza I: Monitorimi i cilësisë së punës së personelit edukativo-arsimor si bazë për planifikimin e zhvillimit profesional
- Faza II: Planifikimi i zhvillimit profesional në funksion të vetëvlerësimit të kompetencave profesionale si bazë për planifikimin e zhvillimit profesional
- Faza III: Efektet e zhvillimit profesional

Zhvillimi profesional në kopshte është i rëndësishëm për të siguruar arsimim dhe kujdes me cilësi të lartë për fëmijët që nga mosha më e vogël. Më poshtë janë dhënë disa arsye pse është i rëndësishëm:

- **Ndikon në përmirësimin e cilësisë së arsimit**

Zhvillimi profesional ndihmon në ripërtëritjen e njohurive dhe shkathtësive të të gjitha profileve profesionale në kopshte. Me metodologjitë dhe teknikat më të fundit, stafi profesional mund të zbatojë novacione. Më konkretisht, zhvillimi profesional krijon kushte që stafi profesional të kuptojë më mirë nevojat e fëmijëve dhe të zbatojë praktika efektive arsimore.

- **Mundëson përshtatjen ndaj ndryshimeve dhe tendencave të reja**

Arsimi dhe edukimi janë procese dinamike që ndryshojnë dhe zhvillohen vazhdimisht. Në këtë drejtim, zhvillimi profesional ndihmon që profilet profesionale në kopshte të kenë njohuri, aftësi dhe shkathtësi aktuale.

- **Ndikon në përmirësimin e komunikimit dhe marrëdhënieve me fëmijët**

Zhvillimi profesional i ndihmon profesionistët e kopshteve të kuptojnë dhe t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve. Ajo shpie në përmirësimin e marrëdhënieve me fëmijët përmes komunikimit efektiv dhe shkëmbimit të ideve.

- **Ndikon në rritjen e kompetencave profesionale**

Zhvillimi profesional rrit njohuritë dhe shkathtësitë për të punuar me fëmijët dhe për të menaxhuar situata të ndërlikuara. Gjithashtu, përmirëson aftësitë organizative dhe drejtuese të profileve profesionale.

- **Ndikon në përmirësimin e rezultateve të fëmijëve**

Zhvillimi profesional siguron arsim cilësor që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e fëmijëve. Procesi arsimor është më i mirë kur zbatohen praktikat më të mira. Një mjedis i tillë i ndihmon fëmijët të arrijnë zhvillimin maksimal dhe të ndihen të sigurt.

- **Krijon një mjedis mbështetës të punës**

Zhvillimi profesional ndihmon edhe në krijimin e një mjedisi pune pozitiv dhe mbështetës. Nxitja e punës në grup dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet profileve profesionale është një lloj zhvillimi profesional për çdo profil profesional. Ndikimi është gjithashtu i madh në përmirësimin e aftësisë për të zgjidhur konfliktet dhe për të menaxhuar stresin.

1. NOCIONE THEMELORE

Zhvillimi profesional – përkufizohet si proces i vazhdueshëm i të mësuarit dhe përmirësimit të shkathtësive, njohurive dhe kompetencave të individit në fushën e tij profesionale. Ky proces synon përmirësimin e efikasitetit, produktivitetit dhe cilësisë së punës, si dhe arritjen e qëllimeve personale dhe profesionale.

Pre-service/initial preparation/initial training - Trajnimi/përgatitja fillestare ose Trajnimi para punës, i ashtuquajtur. Edukimi fillestar i referohet trajnimit në të cilin një individ angazhohet para fillimit të punës. Kjo formë trajnimi siguron që punëtorët të jenë të përgatitur në mënyrë adekuate për të ofruar shërbime në një rol specifik dhe mund të angazhohen në fusha të reja trajnimi.

In-service ose ongoing training - Zhvillimi profesional ose trajnimi në punë është një formë trajnimi në të cilën profesionistët ruajnë dhe zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë dhe praktikën e tyre. Ky trajnim është shpesh si shtesë e trajnimit fillestar me qëllim përmirësimin e njohurive dhe shkathtësive, ruajtjen e licencimit individual ose transferimin në një nivel të ri, përmbushjen e pritshmërive të punëdhënësit ose plotësimin e kërkesave të tjera për profesionistët që punojnë në fushën e fëmijërisë së hershme. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është një formë e trajnimit gjatë shërbimit, i krijuar për të plotësuar nevojat ekzistuese të trajnimit për profesionistët e zhvillimit të fëmijërisë së hershme. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional përfshin idenë që individët synojnë të përmirësojnë vazhdimisht shkathtësitë dhe njohuritë e tyre profesionale përtej trajnimit bazë që kërkohet për të kryer punën.

Programet për zhvillim profesional - këto janë aktivitete të organizuara dhe të planifikuara sistematikisht që synojnë të mundësojnë përmirësimin e profesionistëve përmes trajnimeve, kurseve, punëtorive, seminareve dhe formave të tjera të të mësuarit. Këto programe janë krijuar për të përmirësuar shkathtësitë profesionale, për të përmirësuar njohuritë dhe për të rritur kompetencat e pjesëmarrësve për të arritur standarde më të larta dhe rezultate më të mira në fushën e tyre profesionale.

2. Metodologjia e zhvillimit profesional të profileve profesionale në kopshtet e fëmijëve

Metodologjia e zhvillimit profesional të punonjësve në kopshtet e vendit tonë ndjek rekomandimet e Komisionit Evropian, ku shprehet qartë koncepti, trajtimi dhe struktura e këtij sistemi.

Në fakt, trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve në kopshte duhet të kuptohet si e drejtë dhe detyrim. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve në kopshte bazohet në zhvillimin në fushën e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me programin kombëtar dhe sipas interesave dhe nevojave personale për zhvillim të çdo individi.

Trajnimi i vazhdueshëm i profileve profesionale në kopshte përfshin:

- zhvillim profesional dhe
- avancim në karrierë

Zhvillimi profesional bazohet në standardet profesionale të profesionit, standardet e cilësisë dhe kompetencat profesionale.

Trajnimi i vazhdueshëm i stafit bazohet në konceptin e zhvillimit kumulativ të nivelit të kompetencave të personelit. Niveli i kompetencave i mbuluar nga programet dhe aktivitetet e vazhdueshme të trajnimit ose forma të tjera të zhvillimit profesional vlerësohen sipas:

- Aftësisë së stafit për të mobilizuar, kombinuar dhe përdorur në mënyrë të pavarur aftësitë, njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e përgjithshme dhe profesionale të fituara në përputhje me kërkesat e ndryshme të një konteksti, situatë ose çështjeje specifike.
- Aftësisë së stafit për t'u përbashkuar me ndryshime, situata të ndërlikuara dhe të paparashikueshme.

Fusha e zhvillimit profesional i referohet të mësuarit dhe përmirësimit të vazhdueshëm dhe i jep përgjigje pyetjes se çfarë do të thotë të jesh një edukator i mirë dhe çfarë do të thotë të zbatosh mirë programin, përmes:

- Kuptimi i aranzhimeve konceptuale të programit
- Të menduarit për vetë aranzhimet, por edhe bindjet personale si dhe zbatimin e tyre
- Pjesëmarrja në zhvillimin e praktikave reflektuese në kopshtin e fëmijëve përmes bashkëpunimit, shkëmbimit dhe hulumtimit të përbashkët me bashkëpunëtorë dhe edukatorë profesionistë.
- Rishikim kritik me kolegët për punën, kulturën dhe strukturën e kopshtit
- Lidhja me kolegë nga institucionet e tjera me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe hulumtimeve të përbashkëta
- Pjesëmarrje në projekte zhvillimore në nivel lokal dhe kombëtar
- Përzgjedhja e seminareve për zhvillim profesional që janë relevante për zhvillimin e praktikave reflektuese dhe trajnimit profesional
- Pjesëmarrja dhe prezantimi në takime profesionale

- Monitorimi i literaturës bashkëkohore profesionale dhe trendeve në zhvillimin e arsimit parashkollor
- Shqyrtimi dhe rishikimi kritik i faktorëve social dhe kulturor që formësojnë praktikën e edukimit parashkollor.

Format bazë të zhvillimit profesional janë:

- *(Pre-service/initial preparation/initial training)*
- *(In-service or ongoing training)*

LLOJET E TRAJNIMIT	FORMAT E TRAJNIMIT
Trajnim/mentorim	Trajnimi/kouçing është një proces i bazuar në marrëdhënie, i udhëhequr nga një ekspert me njohuri dhe shkathtësi të specializuara në mësimin e të rriturve, i cili shpeshherë shërben në një rol profesional të ndryshëm nga marrësi(ët). Hanft et al. (2004) përshkruajnë trajnimin në mjediset e fëmijërisë së hershme si përfshirja e vëzhgimeve të pavarura dhe/ose të përbashkëta, demonstrime, praktikë të drejtuar, vetë-reflektim, reagime dhe vlerësime të procesit të trajnimit. Mentorimi është një proces i bazuar në marrëdhënie midis kolegëve në role të ngjashme profesionale, me një individ më me përvojë që ofron udhëzime dhe një shembull për një person me më pak përvojë, përkatësisht të mentoruarit (NAEYC & NACCRRA 2011).
Konferenca, punëtori, seminare	Konferencat dhe seminarët ofrojnë një gamë të gjerë opsionesh për profesionistët për të fituar njohuri dhe/ose shkathtësi në një temë ose fushë specifike. Këto lloj shërbimesh si programet e trajnimit janë afatshkurtra, zakonisht nuk zgjasin më shumë se disa ditë dhe zakonisht organizohen nga shoqata profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto lloj trajnimesh ofrojnë mundësi për të takuar profesionistë dhe paraprofesionistë të tjerë, të cilët mund të sjellin ide të freskëta dhe stimulim për të përmirësuar praktikën (Litjens & Taguma, 2010).
Mësimi nga kolegë: Grupe për reflektim Komunitete profesionale për mësim	Shpesh të kategorizuara si një lloj ndërhyrjeje afatgjatë, grupe reflektimi ose profesionistësh, komunitetet e të mësuarit përfshijnë grupe praktikuesish PVO që reflektojnë mbi praktikën e tyre profesionale dhe identifikojnë pikat e forta dhe fushat për përmirësim. Grupet e reflektimit lehtësohen nga trajnerë të specializuar ose këshilltarë pedagogjikë (Eurofunc, 2015). Qëllimi i këtyre komuniteteve është të krijojnë rrjete të vetë-qëndrueshme, të palëve të interesuara që fokusohen në aplikimin dhe në disa raste në prodhimin e provave të reja në ECD duke integruar gjetjet e kërkimit me njohuritë eksperimentale nga praktikuesit (Sheridan, 2009).
Trajnime për rifreskim	Trajnimi rifreskues ofrohet për të përditësuar dhe ruajtur njohuritë e specializuara për çështjet e anëtarëve të fuqisë punëtore të RDR dhe zakonisht përfshin një kombinim të informacionit dhe metodave të reja, si dhe një rishikim të materialit më të vjetër (Van Dersal, 1962).

<p>Trajnimi lëndor</p> <p>Trajnim i specializuar</p>	<p>Ngjashëm me trajnimin rifreskues, trajnimi lëndor i ndihmon praktikuesit të qëndrojnë të përditësuar me metodat dhe fushat e njohurive të bazuara në shkencë, në mënyrë që ata të mund ta zbatojnë këto njohuri në praktikat e tyre të punës (Litjens & Taguma, 2010). Shërbimi i specializuar në trajnimin e zhvillimit të fëmijërisë së hershme përbëhet nga aktivitete specifike për programet dhe popullatat e fëmijërisë së hershme që ofrojnë udhëzime specifike të shkathtësive ose përmbajtje për ndërtimin e shkathtësive për zbatimin e tyre për punë (Maxwell, 2006; Tout, Zaslow, & Berry, 2006). Trajnimi i specializuar mund të zhvillohet në një mjedis kopshti ose në internet.</p>
--	--

Duke marrë parasysh prejardhjet dhe përvojat e ndryshme të atyre që ofrojnë shërbime të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, programet e trajnimit dhe zhvillimit profesional ofrojnë mundësi për të ofruar një grup thelbësor njohurish dhe shkathtësish për profesionistët që punojnë në këtë fushë. Përveç kësaj, ka prova që sugjerojnë se mbështetja e individëve me këto mundësi mund të ndikojë në rezultatet e zhvillimit të fëmijëve.

Për shembull, një meta-analizë¹ e kohëve të fundit e studimeve globale të programeve të bazuara në arsimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme ka zbuluar se kualifikimet më të larta të edukatorëve shoqëroheshin me përmirësime në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve, duke përfshirë ato që lidhen me mbikëqyrjen dhe aktivitetet, organizimin dhe rregullimin e dhomës, ofrimin e një shumëllojshmërie përvojash sociale për fëmijët dhe krijimin e një mjedisi dhe ndërveprimesh të ngrohta dhe miqësore. Sipas kualifikimeve, hulumtime të tjera sugjerojnë se cilësia e programit arsimor - përkatësisht se sa mirë i përgatit edukatorët, për shembull, duke përmirësuar njohuritë për zhvillimin e fëmijëve dhe të mësuarit nga një fushë akademike - mund të jetë një faktor serioz në aftësinë e një edukatori për të ndikuar në zhvillimin dhe mësimin e fëmijëve në një mënyrë pozitive².

Megjithëse një forcë punëtore e trajnuar mirë dhe e mbështetur në fëmijërinë e hershme konsiderohet kritike për ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për fëmijët dhe familjet, ka pasur përpjekje të kufizuara për të sistemuar qasjet e ndryshme.

Sfidat në lidhje me zhvillimin profesional

1. Ofrues të ndryshëm ofrojnë programe trajnimi dhe zhvillimi profesional për punonjësit e kopshteve për fëmijë, duke çuar në lloje të ndryshme kualifikimesh. Ofruesit e programeve të trajnimit paraprak (pre-service) dhe të trajnimit në shërbim (in-service) janë universitetet, institucionet e arsimit të mesëm profesional, agjencitë qeveritare dhe organizatat joqeveritare (OJQ). Duke qenë se programet e trajnimit mund të ofrohen nga

¹ Manning, M., Garvis, S., Fleming, C., Wong, T. W. G., (2017). *The relationship between teacher qualification and the quality of the early childhood care and learning environment*. Campbell Systematic Reviews.

² Hyson, M., Biggar Tomlinson, H., & Morris, C. (2009). "Quality Improvement in Early Childhood Teacher Education: Faculty Perspectives and Recommendations for the Future." *Early Childhood Research & Practice*.

11(1)

ofrues të ndryshëm, ato mund të çojnë në kualifikime të ndryshme, si diploma, nivele diplomash dhe certifikata.

2. Nuk ka qasje të barabartë në trajnime dhe mundësi për zhvillim profesional për të gjithë.
3. Mbështetja e kufizuar financiare për trajnim dhe zhvillim profesional shkakton pabarazi shtesë për qasjen në shërbime.
4. Ndryshimet në kohëzgjatjen, strukturën dhe intensitetin e programeve të trajnimit kanë implikime cilësore.
5. Programet e trajnimit dhe zhvillimit profesional duhet të plotësojnë nevojat specifike të profesionistëve dhe të jenë relevante për kontekstet lokale.
6. Praktika dhe mundësitë e tjera për të fituar shkathtësi praktike janë komponentë të rëndësishëm të përgatitjes fillestare.
7. Mundësitë e trajnimit gjatë shërbimit (in-service) janë më efektive kur u përshtaten nevojave individuale dhe përfshijnë mësimin nga bashkëmoshatarët.
8. Kushtet, nëse nuk janë të përcaktuara qartë, ndikojnë në cilësinë e trajnimit dhe zhvillimit profesional dhe kufizojnë mundësitë për avancim në karrierë.

Mundësitë e trajnimit dhe zhvillimit profesional u ofrojnë anëtarëve njohuritë dhe shkathtësitë kritike të profesionistëve që punojnë në kopshte. Megjithatë, qasja e kufizuar midis grupeve specifike dhe cilësia e ndryshme, që rezultojnë nga një sërë faktorësh, duke përfshirë kohëzgjatjen e programeve, ekspertizën, specifikën, përfshirjen e përvojave praktike dhe rëndësinë me kontekstet lokale, zvogëlojnë potencialin e tyre për ndikim.

2.1 Menaxhimi i zhvillimit profesional të profileve profesionale në kopshtet e fëmijëve

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, neni 159 rregullon aspektin e zhvillimit profesional të punonjësve në institucionin publik për fëmijë, ku thuhet se ata kanë të drejtën e zhvillimit profesional, për të cilin drejtori miraton plan për zhvillim të vazhdueshëm profesional në përputhje me programin për edukim të vazhdueshëm të ofruesve profesional të shërbimeve publike nga neni 136 i këtij ligji. Institucionet publike për fëmijë krijojnë një sistem për menaxhimin e efektit të ofruesve profesionistë të shërbimeve publike. Sistemi i zhvillimit profesional konsiston në përcaktimin e qëllimeve dhe detyrave të punës, përcaktimin e planit individual për zhvillim profesional, si dhe procedurën për vlerësimin e efektit të ofruesit profesional të shërbimeve publike. Qëllimet dhe detyrat e punës së ofruesit të shërbimit publik në një institucion publik për fëmijë përcaktohen në bazë të programit vjetor të punës së institucionit publik për fëmijë. Qëllimet dhe detyrat e punës së ofruesve të shërbimeve publike duhet të jenë të qarta, të sakta, të matshme dhe me një afat kohor të përcaktuar për realizim. Qëllimet dhe detyrat e punës përcaktohen nga drejtori i institucionit publik për fëmijë ose personi i autorizuar prej tij, në bashkëpunim me ofruesin profesional të shërbimit publik, në dhjetor të vitit aktual për vitin pasardhës. Drejtori i institucionit publik për fëmijët ose personi i autorizuar prej tij, është i detyruar të monitorojë vazhdimisht efektin e ofruesit profesional të shërbimit publik gjatë gjithë vitit dhe, nëse është e nevojshme, të propozojë masa për përmirësimin e tij. Në kuadër të procesit të monitorimit të vazhdueshëm të efektit të ofruesit profesional të shërbimit publik, jo më vonë se data 1 nëntor zhvillohet një intervistë vjetore për vitin aktual.

Pas kryerjes së intervistës vjetore, plotësohet raporti vjetor i intervistës, i cili nënshkruhet nga ofruesi i shërbimit publik profesional dhe drejtori i institucionit publik për fëmijë ose personi i autorizuar prej tij. Një kopje e raportit i jepet ofruesit të shërbimit profesional. Nëse në raportin e intervistës vjetore, drejtori i institucionit publik për fëmijë ose personi i autorizuar prej tij, konstaton se ofruesi profesional i shërbimit publik nuk i ka përmbushur qëllimet e përcaktuara, gjegjësisht tregon rezultate të pakënaqshme gjatë periudhës vjetore, nuk ka treguar ekspertizën dhe kompetencën e nevojshme, ka gabime të theksuara në punë dhe trajtim, kryen detyrat e punës në mënyrë të parakohshme, përkatësisht nuk tregon interes për cilësinë e kryerjes së detyrave të punës, atëherë do të fillojë një procedurë për përmirësimin e efektit.

Në procedurën për përmirësimin e efektit propozohet trajnimi plotësues ose këshillim dhe shqiptohet vërejtje me shkrim me të cilën ofruesi profesional i shërbimit publik paralajmërohet për mundësinë që të vlerësohet me vlerësim negativ, nëse përkundër indikacioneve dhe masave të propozuara, deri në skadimin e vitit pasardhës nga viti në të cilin është kryer vlerësimi, nuk ka përmirësuar efektin e tij. Mënyra e zhvillimit të intervistës dhe vlerësimit vjetor, si dhe forma dhe përmbajtja e raportit dhe formularit të vlerësimit përcaktohen nga ministri.

Zhvillimi profesional i të punësuarve në kopshtet e parapara në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve ofron bazë për konstituimin e sistemit të zhvillimit profesional, por ai nuk është i elaboruar sa duhet dhe nuk thekson elementet thelbësore të procesit, procedurave, mundësive dhe përfitimeve të zhvillimit profesional. Duke vepruar kështu, perceptohet nevoja për t'i dhënë rëndësi dhe trajtim të barabartë të gjitha aspekteve, hapave dhe fazave përkatëse që përbëjnë sistemin e zhvillimit profesional.

Rekomandimet për ndërtimin e një sistemi të plotë të zhvillimit profesional të punonjësve në kopshtet në vendin tonë, të vendosura në kuadër të projektit “Rritja e cilësisë së arsimit parashkollor, edukimit dhe kujdesit”, shkojnë në drejtim të një koncepti, strukture, procedurash të propozuara dhe metodologjinë që trajton dhe zhvillon këtë sistem si më poshtë:

Zhvillimi profesional është një proces i ndërlikuar që nënkupton zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave të të gjitha profileve profesionale në kopshte, me synim cilësinë më të mirë të punës në terren dhe përmirësimin e zhvillimit të fëmijëve dhe nivelin e arritjes së tyre.

Pjesë përbërëse dhe e detyrueshme e zhvillimit profesional është zhvillimi profesional, i cili nënkupton përvetësimin e kompetencave të reja dhe përmirësimin e kompetencave ekzistuese që janë thelbësore për avancimin e punës edukativo-arsimore. Sigurisht, pjesë përbërëse e zhvillimit profesional është zhvillimi për avancim në karrierë në një titull të caktuar.

Profesionistët e të gjitha profileve profesionale në kopshte duhet të planifikohen në përputhje me nevojat dhe fushat prioritare dhe mbi bazën e të kuptuarit të nivelit të zhvillimit të kompetencave të tyre për profesionet e specifikuar të të gjitha profileve profesionale në kopshte.

Institucioni planifikon nevojat dhe prioritetet për zhvillim profesional në bazë të planeve personale për zhvillim profesional të të gjitha profileve profesionale në kopshte, pastaj rezultatet për vetëvlerësim dhe vlerësim të cilësisë së punës së institucionit dhe tregues të tjerë që tregojnë cilësinë e punës edukativo-arsimore.

Plani personal për zhvillimin profesional të të gjitha profileve profesionale në kopshte përgatitet në bazë të vetëvlerësimit të nivelit të zhvillimit të kompetencave.

Këta elementë që përbëjnë sistemin e zhvillimit profesional janë përpunuar në instrumentet metodologjike që tregohen më poshtë në këtë dokument dhe synojnë që nëpërmjet zbatimit të tyre të japin të dhëna të nevojshme që do të mund të tregojnë nevojën reale për zhvillim profesional të të gjitha profileve profesionale në kopshte.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional arrihet përmes aktiviteteve të mëposhtme:

1. Në nivel institucioni realizohen në kuadër të veprimtarive të zhvillimit të brendshëm nëpërmjet:

- Kryerjes së aktiviteteve vizuale të ndjekura nga diskutimi dhe analiza
- Prezantimit gjatë mbledhjeve të organeve profesionale në lidhje me programin e përvetësuar të zhvillimit profesional ose një formë tjetër të zhvillimit profesional jashtë institucionit, shoqëruar me analiza dhe diskutime.
- Prezantimit në libër profesional, doracak, material didaktik, tekst të botuar, kërkime, udhëtim studimor dhe vizita profesionale të shoqëruara me analiza dhe diskutime
- Pjesëmarrjes në: kërkime, projekte edukativo-arsimore në institucion, programe ndërkombëtare, tubime, seminare dhe rrjete, punë në qendra që shërbejnë si model.

2. Pas miratimit të programeve të trajnimit dhe takimeve profesionale

3. Sipas nevojës së ministrisë së linjës dhe institucioneve të tjera përkatëse

4. Në nivel ndërkombëtar duke marrë pjesë në seminare ndërkombëtare, programe trajnimi dhe takime profesionale në fushën e edukimit parashkollor, arsimit dhe kujdesit.

5. Sipas nevojës së të gjitha profileve profesionale në kopshte

6. Realizohet nëpërmjet institucioneve të arsimit të lartë në kuadër të qendrave të mësimin të përjetshëm

Edukatorët, punëtorët profesional, bashkëpunëtorët profesional dhe përkëdhelësit kanë të drejtë dhe detyrë të marrin pjesë në forma të ndryshme të zhvillimit profesional çdo vit shkollor. Kopshti duhet të sigurojë realizimin e të drejtës dhe detyrës për zhvillim profesional të të gjitha profileve profesionale.

2.2 Programet e zhvillimit profesional

Një ndër elementët më të rëndësishëm në zhvillimin profesional janë programet e zhvillimit profesional, të cilat në mungesë të një strukture specifike dhe organizimit të saktë, nuk do të mund të arrinin qëllimet, pritshmëritë dhe rezultatet e përcaktuara.

Ekzistojnë dy lloje të programeve të zhvillimit profesional:

1. **Programet e akredituara:** Programet e zhvillimit profesional që i nënshtrohen një procedure akreditimi në një institucion kompetent në bazë të një konkursi të shpallur. Programet e akredituara për zhvillim profesional janë pjesë e një katalogu që publikohet në faqen e internetit të institucionit kompetent.

Çdo program që kalon në një procedurë akreditimi duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm (të cilët në procesin e aplikimit për akreditim duhet t'i bashkëngjiten fletë-aplikimit të konkursit):

- Emri dhe referenca e organizatorit të programit
 - Referenca e autorit të programit lidhur me temën
 - Referenca e zbatuesit të programit në lidhje me temën e programit, si dhe shkathtësitë dhe përvojën në zbatimin e programit.
 - Rezultatet e hulumtimit që tregojnë se programi i propozuar i zhvillimit profesional çon në arritjen e rezultateve të caktuara të pritura
 - Nëse programi është miratuar më parë, duhet t'i bashkëngjitet numri i programeve të zbatuara dhe numri i pjesëmarrësve
 - Përcaktimi i çmimit për pjesëmarrës dhe specifikimi i çmimeve
2. **Programet me interes publik:** Programet për zhvillim profesional të cilat sipas përmbajtjes, qëllimeve dhe rezultateve të tyre kontribuojnë në zhvillimin dhe avancimin sistematik të punës edukativo-arsimore dhe nuk i nënshtrohen konkursit quhen programe me interes publik. Programet me interes publik miratohen nga ministri përgjegjës për një periudhë tre vjeçare. Programi me interes publik realizohet me fondet e organizatorit dhe është falas për pjesëmarrësit. Organizatori i programit me interes publik mund të jetë organ shtetëror, por nuk mund të jetë njëkohësisht edhe zbatues i programit.

Elementet e programeve të zhvillimit profesional me interes publik janë:

- Titulli
- Qëllimi
- Fusha prioritare të cilës i referohet programi
- Përshkrimi i kompetencave të zhvilluara përmes programit
- Përmbajtja
- Rezultatet e pritshme
- Format e punës
- Grupet e synuara
- Kohëzgjatja e programit
- Orari i aktiviteteve
- Metoda e kontrollit të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të fituara
- Metoda e monitorimit të efekteve të programit

Aspektet e mëposhtme janë karakteristike për të dy llojet e programeve:

- Programi i zhvillimit profesional realizohet me punë të drejtpërdrejtë ose në distancë nëpërmjet internetit.
- Përvojat tregojnë se në shumicën e rasteve një person mund të jetë zbatues deri në pesë programe të miratuara.
- Organizatori i programit u lëshon pjesëmarrësve certifikatën e përfundimit të programit pas përfundimit të programit. Certifikata e përfundimit të programit duhet të përmbajë të dhëna për:

- Pjesëmarrësin (emri dhe mbiemri, data dhe vendi i lindjes, institucioni në të cilin është i punësuar, përkatësisht informacion se pjesëmarrësi nuk është i punësuar)
 - Organizatorin
 - Emrin e trajnimit

 - Numrin e katalogut dhe vitin akademik të cilit i referohet katalogu (për programet e akredituara)/numri i vendimit nga Ministri (për programet me interes publik)
 - Përshkrimin e kompetencave
 - Fushat prioritare të mbuluara nga programi
 - Kohëzgjatja e programit në numër pikësh.
- Certifikata duhet të përmbajë nënshkrimin e zbatuesit të programit, vulën dhe nënshkrimin e personit të autorizuar të organizatorit. Organizatori është përgjegjës për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave.

3. Instrumentet për menaxhimin e zhvillimit profesional të profileve profesionale në kopshtet e fëmijëve

Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të zhvillimit profesional zhvillohet në tre faza:

Faza I: Monitorimi i cilësisë së punës së personelit edukativo-arsimor si bazë për planifikimin e zhvillimit profesional

Faza II: Planifikimi i zhvillimit profesional në funksion të vetëvlerësimit të kompetencave profesionale si bazë për planifikimin e zhvillimit profesional.

Faza III: Efektet e zhvillimit profesional

Faza I:

Monitorimi i cilësisë së punës së personelit
edukativo-arsimor si bazë
për planifikimin e zhvillimit profesional

Monitorimi i cilësisë së punës së stafit arsimor si fazë e parë përfshin instrumentet e mëposhtme:

1. Planifikimi i punës profesionale

2. Monitorimi i aktiviteteve

3. Vlerësimi i nevojave për zhvillim profesional

- Instrumenti i planifikimit profesional të punës synon të monitorojë cilësinë e punës së personelit edukativo-arsimor nëpërmjet vlerësimit të planeve, i cili ndahet në dy kategori: planifikimi i punës edukativo-arsimore dhe lloje të tjera të planifikimit.

Zërat e vendosur në këtë dokument monitorohen dhe vlerësohen përmes 4 kategorive:

C – Plotësisht; D – Pjesërisht; N – pamjaftueshëm; / - Nuk ka mundësi të manifestimit.

(Germat janë C D N janë nga maqedonishtja në interes të kuptimit më të mirë të pjesëve të mëposhtme)

- Instrumenti i monitorimit të veprimtarive të punës edukativo-arsimore në kopshte monitoron konceptin dhe përmbajtjen e kompetencave profesionale. Marrëveshja strukturore bazohet në fushat e kompetencave profesionale për edukatorët, përkëdhelësit, drejtorët, punëtorët profesionistë dhe bashkëpunëtorët profesional në kopshte me qëllim që të arrihet një qasje gjithëpërfshirëse dhe mbulim i plotë i aktiviteteve monitoruese.

Zërat e vendosur në këtë dokument monitorohen dhe vlerësohen përmes 4 kategorive:

C – Plotësisht; D – Pjesërisht; N – pamjaftueshëm; / - Nuk ka mundësi të manifestimit.

- Instrumenti për vlerësimin e nevojave për zhvillim profesional është zhvilluar në drejtim të monitorimit të punës së edukatorit dhe synon të japë informacione për nevojat e analizuara në fushat e kompetencave.

SHTOJCA nr.1**INSTRUMENTI: Planifikimi i punës profesionale**

Viti arsimor	Vlerësoi
Kopshti.....	Data e shqyrtimit.....
Edukatori.....	Konsultime dhe udhëzime
Mosha e grupit	për përmirësim.....

C - plotësisht; D - pjesërisht; N - pamjaftueshëm; / - nuk manifestohet

I	PLANIFIKIMI I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE	C	D	N	/
1.	Merrem vesh m fëmijët për zgjedhjen e temës tjetër të punës dhe mësimi				
2.	I planifikoj aktivitetet në baza javore				
3.	Planifikoj aktivitete me fëmijët e tjerë të kopshtit				
4.	Planifikoj një qasje të integruar ndaj të mësuarit dhe zhvillimit				
5.	Ndjek interesat e fëmijëve në punë dhe sipas tyre e planifikoj punën dhe e përgatitem për atë				
6.	Përdor literaturë profesionale dhe dokumentacion zyrtar për t'u përgatitur për punë				
7.	Përveç literaturës profesionale, përdor burime të tjera informacioni				
8.	Nëse përgjigja nën nr. 7 është plotësisht ose pjesërisht, tregoni se cilat burime të tjera informacioni përdorni: _____ _____ _____ _____				
II	PËRGATITJE DHE PLANE TË VEÇANTA	C	D	N	/
1.	Zbatoj masa për individualizimin e fëmijëve në grupin edukativ				
2.	Planifikoj të bashkëpunoj me prindërit në forma të tjera përveç takimeve prindërore				
3.	Kontaktoj me komunitetin lokal në mënyrë të pavarur				
4.	Një herë në muaj i çoj fëmijët në institucionet e komunitetit lokal				
5.	Realizoj individualizimin e fëmijëve në grupin edukativ				

SHTOJCA nr. 2

INSTRUMENTI: Monitorimi i aktiviteteve

Viti arsimor	Vlerësoi.....
Kopshti.....	Data e shqyrtimit.....
Edukatori.....	Konsultime dhe udhëzime
Mosha e grupit	Për përmirësim.....

Përshkrimi: C - plotësisht; D - pjesërisht; N - pamjaftueshëm; / - nuk manifestohet

I	ZHVILLIMI DHE MËSIMI I FËMIJËVE	C	D	N	/
Bashkëpunëtori profesional	Punon me fëmijë që kanë përvoja të ndryshme sociale dhe karakteristika të ndryshme personale				
	Punon me fëmijët duke respektuar dallimet e tyre (kulturore, gjuhësore, gjinore, sociale...)				
	I drejtohet për ndihmë një personi/institucioni kompetent kur ka sjellje të pakujdesshme në familje				
	Mbështet edukatorin në përpjekjet e tij/saj për të punuar drejt realizimit të interesave më të mira të fëmijës				
	Tregon mënyrat në të cilat fëmija mund të zgjedhë qasje të ndryshme për të mësuar				
	Zbaton procedura që mund të konfirmojnë ekzistencën e aftësive ose dhuntive të veçanta tek fëmijët				
	Propozon dhe/ose sajon mënyra për të zbatuar metoda që nxisin aftësitë dhe dhuntitë e veçanta tek fëmijëve				
	Propozon masa dhe monitoron përparimin e fëmijëve në fushën e ofrimit të mbështetjes arsimore				
Edukatori	Punon me fëmijë nga - deri në 6 vjeç në përputhje me specifikat e tyre zhvillimore.				
	Iu mundëson fëmijëve të zbatojnë autenticitetin dhe diversitetin e tyre në kopsht (nëse është në përputhje me normat morale dhe rregullat e kopshtit).				
	Dallon periudhat e krizës në zhvillimin e fëmijëve për shkak të sjelljes së pakujdesshme të prindërve.				
	Është i gatshëm ta mbrojë fëmijën nga sjellja e papranueshme dhe e pakujdesshme e prindërve.				
	Ofron materiale sipas moshës së fëmijës.				
	Ka një listë kontrolli sipas së cilës ai mund të monitorojë përparimin e secilit fëmijë në grup dhe të përcaktojë ekzistencën e aftësive dhe dhuntive të veçanta tek fëmijët.				
	Mundëson situata me pritshmëri të mëdha në kopsht dhe/ose në sallën e punës, të cilat ngjallin gëzim tek fëmijët dhe stimulojnë aktivitete të mëtejshme.				
	Zbaton masat dhe monitoron përparimin e fëmijëve në fushën e ofrimit të mbështetjes arsimore.				

II	MJEDISI	C	D	N	/
Bashkëpunëtori profesional	U tregon praktikuesve se si mjedisi nxit dhe mundëson mësimin e hershëm të fëmijërisë				
	Promovon ndërtimin e një mjedisi që nxit hulumtimin, mësimin dhe pavarësinë tek fëmijët				
	Jep udhëzime për përshtatjen e hapësirave, mjeteve dhe materialeve didaktike sipas nevojave të fëmijës				
	Ndryshon hapësirat në sallën e punës dhe së bashku me edukatorin krijojnë mjete dhe materiale didaktike				
	Zbaton mbrojtjen sociale parësore (masat më të përgjithshme parandaluese) për të siguruar një mjedis të sigurt				
	Vlerëson hapësirat dhe në mënyrë indirekte ndërhyr për të siguruar një mjedis të sigurt për fëmijët				
	Zbaton dhe mbron të drejtat dhe interesat e fëmijëve që përkojnë në grupet vulnerabël, ndërsa brenda institucionit realizon mbrojtjen dhe zbatimin e tyre.				
Edukatori	Siguron një mjedis që nxit hulumtimin, mësimin dhe pavarësinë tek fëmijët				
	Krijojnë një mjedis në të cilin çdo fëmijë ndihet i sigurt dhe i lirë për të shprehur idetë dhe opinionet e tij, pa frikë nga përgjigjet e gabuara				
	Përshtat materialin sipas moshës së fëmijës				
	Materiali në hapësira është i disponueshëm për të gjithë fëmijët				
	Zbaton sugjerimet dhe udhëzimet e punëtorit profesional në lidhje me rëndësinë e mjedisit për mësimin dhe zhvillimin e fëmijës.				
	Ndryshon hapësirat, mjetet didaktike dhe materialet sipas nevojave të fëmijës				
	Bashkëpunon me punëtorin profesional kur ndërron hapësirën, mjetet dhe materialet për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje shtesë				
	Përshtat hapësirat në atë mënyrë që mundëson realizimin e të drejtës së përfshirjes së fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje shtesë arsimore në kopshtin e fëmijëve.				
	Mbron të drejtat dhe interesat e fëmijëve nga grupet vulnerabël dhe realizon mbrojtjen dhe zbatimin e tyre në nivel institucioni				
	Bashkëpunon me shërbimin e kujdesit shëndetësor parandalues në kopshtin e fëmijëve				
	Zbaton shprehjet kulturo-higjienike dhe kujdeset për sigurimin e gjendjes optimale shëndetësore për të gjithë fëmijët gjatë kohës që janë në kopsht.				
Krijojnë një mjedis të favorshëm për fëmijët që kanë probleme shëndetësore (alergji, diabet tip 1...) dhe i rregullojnë ato - kujdeset për llojin e ushqimit, ofron terapi...					

III	ORGANIZIMI DHE KLIMA	C	D	N	/
Punëtori profesional	Propozon masa për përmirësimin e punës në kopshtin e fëmijëve bazuar në programin e përcaktuar të punës për punën në kopsht dhe specifikën e vetë objektit.				
	Merr pjesë aktive në krijimin e etikës në kopshtin e fëmijëve				
	Promovon një klimë respekti dhe bashkëpunimi të ndërsjellë				
	Përdor mënyra të ndryshme për të avancuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërpersonale				
	Promovon një klimë të të mësuarit dhe avancimit të vazhdueshëm				
	Realizon hulumtime dhe projekte në kopshtin e fëmijëve				
	Në praktikë, zbaton dialog konstruktiv (ose kompetenca për kulturë demokratike) dhe metoda jo të dhunshme të zgjidhjes së konflikteve.				
	Kryen ndërmjetësim				
Edukatori	Kryen ndryshime të hapësirave për të stimuluar fëmijët të hulumtojnë dhe të përparojnë				
	Përcakton qartë hapësirat për forma të ndryshme të mësimit				
	Krijon një klimë bashkëpunimi midis fëmijëve në hapësirat e punës				
	Mban marrëdhënie të mira ndërpersonale me punonjësit e tjerë				
	Organizimi i kohës është në interesin më të mirë të fëmijëve, e jo të aktivitetit				
	Nxit fëmijët të përdorin stile të ndryshme të të shprehurit				
Me veprimet e veta, ushqen autenticitetin e çdo fëmije dhe mbështet bashkëpunimin					

IV	PROCESI EDUKATIVO-ARSIMOR	C	D	N	/
Punëtori profesional	Njeh normat (dokumentet dhe standardet programore) që i referohen edukimit parashkollor, arsimit dhe kujdesit				
	Ofron mbështetje profesionale për punonjësit në zbatimin e programeve të përcaktuara sipas specifikave të institucionit				
	Inkurajon hulumtimin, mësimin, zhvillimin dhe pavarësinë e fëmijëve në një mjedis që stimulon dhe mbështet procesin njohës të fëmijës				
	Nxit praktikuesit që të marrin vlerësimin e punës së tyre si pikënisje për përmirësimin e punës së tyre me fëmijët				
	Bazuar në monitorimin e punës së praktikuesve, sugjeron pjesëmarrjen në projekte/aktivitete që do të avancojnë punën edukativo-arsimorë				
	Njeh metodologjinë e kërkimit shkencor				
	Kryen kërkime për të përmirësuar punën arsimorë				
	Interpreton rezultatet e hulumtimit dhe i lidh ato me praktikën edukativo-arsimorë				
Edukatori	Monitoron zbatimin e programit të përcaktuar dhe me vetëdije e përshtat atë me specifikat e komunitetit lokal, objektit, grupit të fëmijëve etj.				
	Menaxhohet sipas qëllimeve afatgjata dhe krijon situata me të cilat shkathtësitë e jetës, aftësitë dhe njohuritë lidhen në një tërësi kuptimplote që ka kuptim për fëmijën.				
